

Бр.Нр. 03-654/2

05.05 2026 година

Raporti mbi aktivitetet e realizuara të Këshillit të nxënësve 2025-2026.

Gjatë vitit shkollor 2025/2026 u mbajtën mbledhje të shumta të Këshillit të nxënësve për të diskutuar çështje me interes për nxënësit. Në punën e Këshillit të nxënësve morën pjesë kryetarët e të gjitha klasave, kryetarja e Këshillit të nxënësve, nënkryetari, sekretari i përgjithshëm, dy mësimdhënës dhe një bashkëpunëtor profesionist, të zgjedhur nga Këshilli arsimor.

Më datë 12.2.2026 u mbajt mbledhje kushtetuese e Këshillit të nxënësve, në të cilën, në përputhje me Rregulloren për punë, me votim të fshehtë, u zgjodhën anëtarët e mëposhtëm:

- Kryetare: Kristina Krajçeva IV-2;
- Nënkryetare: Ermira Nebia II-3;
- Sekretare e përgjithshme: Angjela Filipoviç II-1;
- Koordinator për vitin I: Robert Arsov I-2;
- Koordinatore për vitin II: Angjela Filipoviç II-1;
- Koordinator për vitin III: Altin Mehmed III-8;
- Koordinator për Vitin IV: Ergin Aliu IV-4.
- dy përfaqësues të Këshillit të nxënësve: Gjorgi Dimovski IV-1 dhe Burhan Sejfulla IV-5;
- tre anëtarë të Këshillit të nxënësve për komisionin për zgjedhjen e avokatit të nxënësve dhe zëvendës avokatit: Gjorgi Dimovski IV-1, Burhan Sejfulla IV-5, Ergin Aliu IV-4.

Këshillit i nxënësve përbëhet gjithashtu nga dy mësimdhënës dhe një bashkëpunëtor profesional, të zgjedhur nga Këshilli arsimor: Mimoza Giçevska – mësimdhënëse, Halime Demir-Horuni – mësimdhënëse dhe Elena Petrovska – bashkëpunëtoresh profesionale (psikologe).

Mbledhja i dytë i Këshillit të nxënësve u mbajt më 30.03.2026 dhe u kryesua nga Kryetarja e Këshillit të nxënësve Kristina Krajçeva. Në mbledhje u realizua zgjedhja e Trupit koordinues të Këshillit të nxënësve, i cili sipas Rregullores për punë përbëhet nga koordinatore sipas viteve dhe një përfaqësues i mësimdhënësve të përzgjedhur nga drejtori. Trupi koordinues përbëhet nga anëtarët e mëposhtëm:

- Robert Arsov I-2, Koordinator i vitit të parë;
- Angjela Filipoviç II-1, Koordinatore e vitit të dytë;
- Altin Mehmed III-8, koordinator i vitit të tretë;
- Ergin Aliu IV-4, Koordinator i vitit të katërt;

- Koce Tapshanovski, mësimdhënës.

Në përputhje me rendin e ditës dhe Rregullores për punë, u zgjodh një Komision për besim dhe bashkëpunim, i përbërë nga anëtarët e mëposhtëm:

- Angela Filipoviç, sekretare e përgjithshme;
- Elena Petrovska, psikologe;
- Kristina Krajçeva, kryetare e Këshillit të nxënësve.

Në mbledhje, u realizua edhe një diskutim me temë "*Ndërgjegjësimi i nxënësve për dëmin e përdorimit të substancave psikoaktive*", gjatë të cilit nxënësit morën pjesë aktive me mendimet dhe sugjerimet e tyre.

Më datë 28.4.2026 u mbajt mbledhja e tretë e Këshillit të nxënësve. Në mbledhje, psikologja e shkollës, zbatoi një punëtori për *Njohjen dhe parandalimin e hershëm të dhunës*, me qëllim informimin dhe edukimin e nxënësve. Prezantimi mbuloi konceptet themelore që lidhen me dhunën, format dhe pasojat e saj, si dhe mekanizmat për reagimin dhe njohjen në kohë.

U diskutua gjithashtu për suksesin e arritur dhe notat e nxënësve, sjelljen e tyre gjatë mësimit dhe bashkëpunimin me mësimdhënësit. Çështjet dhe propozimet aktuale u paraqitën për të përmirësuar klimën shkollore dhe organizimin e aktiviteteve të ardhshme.

Me iniciativën e Kryetares së Këshillit të nxënësve u hap një diskutim për organizimin e një ekskursioni. Nxënësit pranuan propozimin dhe shprehën interes për realizimin e ekskursionit, nëse plotësoheshin kushtet e nevojshme.

Në takimin e fundit, i cili u mbajt më 5.5.2026, u mbajt një punëtori me temë *Llojet e konflikteve dhe zgjidhja efektive e tyre*. Gjatë punëtorisë, nxënësit u njohën me konceptin e *konfliktit*, llojet e konflikteve që ndodhin më shpesh në jetën e përditshme dhe në shkollë, si dhe arsyet e shfaqjes së tyre. Konfliktet midis nxënësve. Përmes diskutimit dhe shembujve, nxënësit mësuuan se si konfliktet mund të zgjidhen në mënyrë paqësore dhe efektive duke përdorur komunikimin e duhur, respektin për bashkëbiseduesin, dëgjimin aktiv dhe mirëkuptimin e ndërsjellë. U theksua rëndësia e kontrollit të emocioneve, shmangia e fyerjeve dhe sjelljeve të dhunshme, si dhe nevoja për bashkëpunim dhe tolerancë në komunikimin e përditshëm.

Nxënësit morën pjesë aktive në punëtori, shprehën mendimet, përvojat dhe shembujt e tyre nga jeta e përditshme, duke kontribuar kështu në zbatimin e suksesshëm të aktivitetit.

Gjithashtu u përgatit dhe u shqyrtua një raport mbi veprimtarinë e Këshillit të nxënësve. Anëtarët e pranishëm diskutuan aktivitetet dhe miratuan njëzëri raportin.

Si përfundim nga të gjitha mbledhjet e Këshillit të nxënësve, mund të konkludohet se nxënësit kanë treguar interes, aktivitet dhe përgjegjësi për pjesëmarrje në punën e Këshillit të nxënësve. Përmes aktiviteteve të realizuara, ata kontribuan në zhvillimin e kulturës demokratike, përmirësimin e komunikimit, bashkëpunimin e ndërsjellë dhe një klimë pozitive shkollore.

Kryetare Këshillit të nxënësve:

Kristina Krajçeva



Sekretare e Këshillit të nxënësve:

Angjela Filipoviq



Përktheu:

Jehona Asani

